VENDIM
Nr.501, datë 23.7.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT TË FORMËS "BOO", NDËRMJET MINISTRISË SË INDUSTRISË DHE TË ENERGJETIKËS, MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT, SI ORGAN SHTETËROR I AUTORIZUAR (OSHA), DHE SHOQËRISË "WONDER" SH.A. PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT TË SASAJT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 9 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbime publike dhe infrastrukturë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës "BOO", ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, si Organ Shtetëror i Autorizuar (OSHA), dhe shoqërisë "Wonder" sh.a., Tiranë, për ndërtimin e hidrocentralit të Sasajt, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
KONCESIONI E FORMËS "BOO" (NDËRTIM, PRONËSI, SHFRYTËZIM PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT TË SASAJT)

Ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrisë së Bujqësisë e të Ushqimit, përcaktuar si "Organ Shtetëror i Autorizuar" (OSHA), nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.634, datë 18.9.2003, që më poshtë do të quhet i tillë, dhe shoqërisë "Wonder" sh.a., regjistruar si person juridik me vendimin nr.25389, datë 9.3.2001 të Gykatës së Rrethit Tiranë, që më poshtë do të quhet "Koncesionari".

HYRJE

Duke pasur parasysh që Qeveria shqiptare:

- Autorizon sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.634, datë 18.9.2003 "Për fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion, të formës "BOO" të hidrocentralit të Sasajt", Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, të negociojnë dhe të nënshkruajnë Marrëveshjen e koncesionit;
- Konsideron privatizimin e sektorit elektroenergjetik si një element të rëndësishëm të politikës elektroenergjetike;
- Vlerëson formën "BOO" të koncesionit, që bën të mundur ndërtimin e hidrocentraleve vendore pa prekur Buxhetin e Shtetit;
- Është e angazhuar për ngritjen dhe për zhvillimin e tregut të enegjisë elektrike brenda vendit;
- Mirëpret investitorët vendas në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike.

Koncesionari:

- Është seriozisht i interesuar të investojë në fushën e elektroenergjetikës;
- Zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara, si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare, që vërtetohen me dokumentet e paraqitura nga ai;

- Ka kryer studimin tekniko-ekonomik për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentralit të Sasajt, objekt i këtij koncesioni;

- Ka përgatitur projektidenë, në muajin mars 2003, bazuar në detyrën e projektimit të dërguar nga ana e tij, Institutit të Studimeve e Projektimeve Hidroteknike Tiranë, për studimin dhe projektimin e H/C Sasaj;

- Ka paraqitur pranë Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës, me shkresën nr.41 Prot., datë 11.4.2003, kërkesën për një propozim të pakërkuar të formës "BOO" për ndërtimin e hidrocentralit të Sasajt;

- Ka marrë nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, me shkresën nr.2717 Prot., datë 5.5.2003 kërkesat për plotësim të dokumentacionit dhe për kryerjen e oponencës nga Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë;

- Ka dërguar në Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës, me shkresën nr.47 Prot., datë 28.5.2003, dokumentacionin plotësues dhe oponencën;

- Ka marrë nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, me shkresën nr.2717/2 Prot., datë 2.6.2003 kërkesën për sqarime të oponencës të kryer nga Akademia e Shkencave, për H/C Sasaj;

- Ka dërguar në Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës, me shkresën nr.51 Prot., datë 23.6.2003 plotësimin e oponencës të kërkuar nga ajo;

- Ka marrë nga Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, me shkresën nr.4148/8 prot., datë 1.10.2003 vendimin e Këshillit të Ministrave nr.634, datë 18.9.2003 "Për fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion të formës "BOO" të hidrocentralit të Sasajt".

Palët

Bien dakord që të bashkëpunojnë për ndërtimin e hidrocentralit Sasaj, me koncesion të formës "BOO", që më poshtë do të quhet "Hidrocentrali";

Neni 1

Përkufizime

Kudo që në këtë Marrëveshje përdoren termat e mëposhtëm, ata do të kenë kuptimet përkatëse të shënuara si vijon:

- Marrëveshja e koncesionit: Kjo Marrëveshje dhe aneksi nr.1;

- Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA): Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;

- Koncesionari: Shoqëria "Wonder" sh.a., rruga "Ismail Qemali", Qendra e Biznesit kati i III-të, pallati përballë INIMA-s, Tiranë, me president Z.Vasil Gjika;

- Hidrocentrali: Hidrocentrali Sasaj, në rrethin e Sarandës me nënobjektet;

- Kontratat: Të gjitha kontratat e lidhura nga Koncesionari për realizimin e projektit;

- Lejet: Lejet, licencat, autorizimet dhe koncesionet që Koncesionari mund t'u kërkojë autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë, për zbatimin e plotë të projektit, si dhe për stafin e vet, në bazë të ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

- Fillimi i punimeve: Periudha njëzetmujore pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje koncesioni;

- ERE: Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike;

- KESH sh.a.: Korporata Elektroenergjetike Shqiptare;

- KK UJËRAVE: Këshilli Kombëtar i Ujërave.

Neni 2

Objekti i koncesionit

Objekti i koncesionit është:

- E drejta që Organi Shtetëror i Autorizuar i ka dhënë Koncesionarit, në bazë të termave dhe kushteve të parashtuara në nenet e kësaj Marrëveshjeje, për ndërtimin, pronësinë dhe shfrytëzimin e hidrocentralit Sasaj në rrethin e Sarandës, për prodhimin e energjisë elektrike, sipas projektidesë së paraqitur nga Koncesionari, pranë Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës;

- E drejta që Organi Shtetëror i Autorizuar i ka dhënë Koncesionarit për përdorimin e kanalit ekzistues nga burimi deri te tuneli me gjatësi rreth 1,2 km, tunelit me gjatësi rreth 2,35 km dhe kanalit ekzistues 3,53 km mbas tunelit, për vendin e parashikuar në projekt për basenin me presion me kapacitetet 12 000 m^3, për vendin e parashikuar në projekt për tubacionin e turbinës me gjatësi 810 ml, për vendin e parashikuar në projekt për kapërderdhësin anësor, ndërtesën e centralit, nënstacionin 35 kV, kanalin me gjatësi 60 ml, pra veprën hidroenergjetike të kompletuar.

Neni 3

Karakteristikat e hidrocentralit Sasaj

Karakteristikat kryesore janë:

Prurja	Qllog=Qhc=3,2 m^3/sek
Kuota e nivelit të ujit në anën e sipërme	219,55-222,05 metër absolut
Kuota e nivelit të ujit në anën e poshtme	4,25-5,10 metër absolut
Prurja normale e turbinës	1,2-2m^3/sek
Tipi i turbinës	Frensis, me aks horizontal
Diametri i rrotës së punës	950 mm
Numri i rrotullimeve të turbinës	1000 rrotullime/min
Fuqia e H/C-it	N= 5.500 kW
Prodhimi mesatar vjetor i energjisë	E= 23 milion kWh

Vëllimet kryesore të punimeve:

1. Gërmime dheu	64 000 m^3
2. Betone dhe betonarme	8 500 m^3
3. Hekur betoni	160 ton
4. Tubacion metalik	300 ton

Neni 4

Detyrimet e Koncesionarit

Koncesionari është i detyruar të zbatojë projektin dhe objektin e Marrëveshjes konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanërisht Koncesionari angazhohet që:

- Të mbledhë të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme për projektin që do të zbatojë;
- Të projektojë dhe të ndërtojë këtë hidrocentral konform standardeve të përparuara bashkëkohore;
- Të ndërtojë hidrocentralin Sasaj, duke siguruar vetëfinancimin e tij, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet kësaj Marrëveshjeje;
- Të formojë shoqërinë koncesionare brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes së koncesionit;
- Të respektojë të gjitha dispozitat ligjore shqiptare që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive koncesionare;
- Të marrë masa me qëllim që çdo investim të jetë sipas afateve në këtë Marrëveshje dhe me cilësinë e kërkuar;
- Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'u shkaktohet palëve të treta;
- Të mbajë të informuar OSHA-në për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;
- Të ndjekë dhe të zbatojë të gjitha dispozitat ligjore për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe për marrëdhëniet e punës;
- Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi;
- Të marrë të gjitha masat paraprake, me qëllim që të garantojë kushte teknike për punëtorët dhe për të tretët, për të shmangur dëmet ndaj pronës publike dhe private dhe të respektojë legjislacionin në fuqi, si dhe dispozitat e tjera për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë;

- Të realizojë kontrata të përshtatshme sigurimi për të mbuluar çdo risk të mundshëm;
- Të zgjidhë problemin e përdorimit të ujit pranë Këshillit Kombëtar të Ujërave, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;
- Të ruajë regjimin e ujitjes gjatë sezonit dhe të mos dëmtojë nënveprat që shërbejnë për marrjen e ujit nga kanalet ujitëse, gjatë rikonstruksionit dhe përdorimit të tyre nga shoqëria koncesionare;
- Të përjashtojë çdo lloj përgjegjësie të OSHA-së, përsa parashikohet në këtë nen, për dëmet, dëmtimet dhe të tjera që mund t'i ndodhin Koncesionarit dhe punonjësve të tij gjatë periudhës së koncesionit.

Neni 5
Detyrimet e OSHA

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) merr përsipër detyrimet e mëposhtme:
- Të ndihmojë Koncesionarin për aplikimet, marrëveshjet ose kontratat e nevojshme për zbatimin e projektit me institucionet e tjera si ERE, KK i Ujërave, KESH etj.;

- Të ndihmojë Koncesionarin në finalizimin e një marrëveshjeje afatgjatë me KESH sh.a., për shitjen e energjisë elektrike, për aq kohë sa KESH sh.a., të jetë me kapital tërësisht shtetëror;
- Të ndihmojë Koncesionarin pranë KESH-it ose pranë institucioneve kompetente, për marrjen e lejes së nevojshme, për lidhjen me sistemin elektroenergjetik dhe transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentrali Sasaj;
- Të asistojë pranë çdo institucioni shtetëror dhe organi vendor, kur është e nevojshme, me qëllim që Koncesionari të ushtrojë veprimtarinë koncesionare;
- T'i vërë në dispozicion Koncesionarit zonën e koncesionit brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes;
- Të mos nënshkruajë marrëveshje me asnjë person fizik ose juridik vendas apo të huaj, që në ndonjë mënyrë mund të sjellin direkt apo indirekt, efekte që mund të zvogëlojnë prurjet e burimeve të Tatzatit, si dhe prurjet e ujit përgjatë veprave të përcaktuara në objektin e kësaj Marrëveshjeje, deri në ndërtesën e hidrocentralit.

Neni 6
Vlerësimi i investimeve

Mbi bazën e të dhënave të disponueshme deri tani, investimet e nevojshme për objektin e kësaj kontrate janë vlerësuar rreth 9.45 milionë USD, bazuar në studimin e prifizibilitetit, që përmban relacionin teknik dhe planimetritë bashkëlidhur.

Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve:
- pas variantit përfundimtar të projektzbatimit;
- në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës, sipas efektivitetit të ofertave.

Koncesionari do t'ia paraqesë OSHA-së situacionet e punimeve me kërkesën e saj.

Neni 7
Shitja e energjisë elektrike të prodhuar

Shitja e energjisë elektrike të prodhuar do të bëhet sipas çmimit të aprovuar nga Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE). Autorizohet shoqëria shpërndarëse elektrike, me kapital tërësisht shtetëror, të lidhë me Koncesionarin një marrëveshje afatgjatë, për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar, për një periudhë kohore për të cilën palët do të bien dakord.

Neni 8
Furnizimi me ujë

Në zbatim të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", Koncesionari do të aplikojë pranë Këshillit Kombëtar të Ujit për lejen e përdorimit të ujit.

Në këtë kuadër Koncesionari merr përsipër të ruajë regjimin e ujitjes gjatë sezonit dhe të mos dëmtojë nënveprat që shërbejnë për marrjen e ujit nga kanalet ujitëse, gjatë rikonstruksionit dhe përdorimit të tyre. Organi Shtetëror i Autorizuar, në rast nevoje, asiston në zgjidhjen e të gjitha problemeve të bashkëveprimit dhe të përdorimit të ujit, në interes të përdoruesve të ujit për ujitje dhe të Koncesionarit.

Neni 9

Vënia në dispozicion e vendit të ndërtimit sipas projektit të paraqitur

Koncesionari, mbi bazën e nevojave të projektit do t'i propozojë OSHA-së zona, të cilat do të shpronësohen.

Zonat private do të shpronësohen sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen e përdorimit të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik". Efektet financiare të shpronësimeve përballohen nga Koncesionari.

Neni 10

Servitutet e zonës

Në rastin e ekzistencës së kanalizimeve të mundshme nëntokësore (ujë, gaz etj.) (përjashto linjat elektrike) që mund të ndërhyjnë në zonat e interesuara, OSHA-ja në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, do të marrë masa për të gjetur zgjidhje sipas së drejtës civile shqiptare, që të lejojnë Koncesionarin të realizojë dhe të administrojë hidrocentralin pa asnjë kufizim operativ.

Neni 11

Programi i punimeve

Palët angazhohen të respektojnë programin e mëposhtëm:

1. Koncesionari merr përsipër të përfundojë projektzbatimin brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.
2. Koncesionari merr përsipër të fillojë punën brenda 20 (njëzet) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.
3. Koncesionari merr përsipër të përfundojë këtë hidrocentral brenda 40 (dyzet) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.
4. Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje midis dy palëve.

Neni 12

Periudha e koncesionit

Në përputhje me këtë Marrëveshje koncesioni, OSHA-ja i jep Koncesionarit të drejtën e ndërtimit të hidrocentralit Sasaj.

Përfundimi i punimeve dhe i vënies në punë të hidrocentralit shprehet nëpërmjet paraqitjes së një raporti të hollësishëm të përgatitur dhe të miratuar nga të dyja palët.

Periudha koncesionare do të jetë 30 (tridhjetë) vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje koncesionare.

Neni 13

Zgjidhja e Marrëveshjes së koncesionit

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) ka të drejtë të kërkojë prishjen e Marrëveshjes së koncesionit në mënyrë të njëanshme, për rastet kur konstaton shkelje të vazhdueshme dhe të rënda të detyrimeve të marrësit të koncesionit në këtë Marrëveshje, të cilat kompromentojnë grafikun e investimit, cilësinë e punimeve dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Kur nga ana e OSHA-së provohet se gjatë periudhës së koncesionit, ka shkelje të ndonjë prej pikave të përmendura në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje, ai menjëherë ia bën të njohur këto shkelje Koncesionarit dhe është i detyruar të presë për një periudhë 60-ditore përgjigjen e tij, me argumentet

përkatëse.

Mbi bazën e përgjigjeve arsyetohen për të filluar ose jo procedurat për prishjen e Marrëveshjes.

Neni 14
Kontratat

Me qëllim që të realizohet objekti i koncesionit, Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje.

Në të gjitha kontratat e sipërmarrjes ose nënkontraktorët, Koncesionari angazhohet të respektojë klauzolat dhe normat e fiksuara në këtë Marrëveshje koncesioni.

Pavarësisht nga kontratat e mësipërme, përgjegjës para OSHA-së për zbatimin e rregullt të këtyre kontratave mbetet gjithmonë Koncesionari.

Me përjashtim të të drejtave dhe detyrave që i jepen OSHA-së në këtë kontratë, OSHA-ja nuk do të marrë përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve.

Neni 15
Sigurimet

Koncesionari do të sigurojë objektin gjatë gjithë periudhës së koncesionit.

Koncesionari do t'i japë OSHA-së, me kërkesën e saj, dokumentet për të gjitha llojet e sigurimeve.

Në rast se objekti i siguruar shkatërrohet për shkak të rreziqeve ndaj të cilave është siguruar, zhdëmtimet në para të marra nga Koncesionari do të përdoren për të rindërtuar, për të riparuar, për të risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendje funksionale.

Neni 16
Zonat e sigurisë

OSHA-ja dorëzon te Koncesionari, bashkë me zonat e tjera të përcaktuara në objektin e kësaj Marrëveshjeje, edhe zonën e sigurisë së tyre, në përputhje me nenin 61 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike".

Neni 17
Provat dhe vënia në punë

Provat për vënien në punë të hidrocentralit do të bëhen nga Koncesionari dhe në përfundim të tyre hartohet akti për përfundimin me sukses të provave. Që nga ky moment hidrocentrali konsiderohet i gatshëm për shfrytëzim.

Në kryerjen e provave mund të asistojnë dhe përfaqësues të OSHA-së.

Neni 18
Regjistrimi i hidrocentralit në ZRPP

Mbas vënies së hidrocentralit në punë, brenda 90 ditëve, OSHA-ja dhe Koncesionari hartojnë një akt dhe një situacion përmbledhës përfundimtar në të cilin përcaktohet se ndërtimi i hidrocentralit ka përfunduar sipas projektit dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje koncesionare. Ky dokument, së bashku me gjithë dokumentet e tjera që kanë shërbyer për realizimin e tij, dorëzohen pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme të rrethit Sarandë, e cila bën regjistrimin e hidrocentralit në emër të Koncesionarit.

Kur është e nevojshme dhe me miratim të Organit Shtetëror të Autorizuar, Koncesionari mund të hipotekojë si garanci pasuritë e shoqërisë, me kusht që pasuritë e hipotekuara të vazhdojnë të shfrytëzohen për të përmbushur objektivat e kontratës së koncesionit.

Neni 19

Kontrolli, raportimi, inspektimet dhe mbikëqyrja e përgjithshme

OSHA-ja ruan të gjitha të drejtat kontrolluese mbi Koncesionarin gjatë gjithë periudhës së koncesionit.

Koncesionari është i detyruar që çdo gjashtë muaj të raportojë me shkrim pranë OSHA-së, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas prodhimin e energjisë elektrike.

OSHA-ja ruan të drejtën që gjatë periudhës së koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të kontrollojë objektin për të vërtetuar se dispozitat e koncesionit do të kryhen sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

OSHA-ja mund të ushtrojë një mbikëqyrje të përgjithshme gjatë realizimit dhe vënies në punë, me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, ashtu si cilësia dhe konformiteti, të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionit të projektit.

Në rast të shkeljeve të Marrëveshjes, konstatuar gjatë kontrollit të përgjithshëm, Koncesionari do të njoftohet me shkrim dhe do të vërë në zbatim masat e nevojshme për të ardhmen.

Neni 20

Legjislacioni i zbatueshëm

Zbatimi dhe interpretimi i kësaj Marrëveshjeje koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje. Për çdo gjë të paqartë, palët në kontratë do t'i referohen legjislacionit të shtetit shqiptar.

OSHA-ja garanton që çdo ligj i mëvonshëm që mund të interferojë me këtë Marrëveshje koncesioni, nuk do të ndryshojë në asnjë mënyrë detyrimet e marra përsipër nga palët sipas kësaj Marrëveshjeje koncesioni.

Neni 21

Forcat madhore dhe të parashikuara

Konsiderohen ngjarje të forcës madhore katastrofat e natyrës, përmbytjet, tërmetet, lufta dhe ndërhyrja e palëve të treta që kanë fuqinë e ligjit dhe çdo ngjarje e barabartë që mund të ndikojë në objektin e kësaj Marrëveshjeje, duke bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të Marrëveshjes, që kanë të bëjnë me vullnetin e palëve.

Gjatë zbatimit të kontratës, në rast se verifikohen vonesa të mundshme ose mosrespektime të detyrimeve të palëve, për shkak të ngjarjeve të forcës madhore, ato nuk mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim.

Në këtë rast, kur një detyrim i kësaj Marrëveshjeje do të prishet ose do të hiqet si rezultat i forcës madhore, pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë me shkrim palën tjetër, brenda 15 ditëve, duke i treguar dhe duke arsyetuar shtyrjen e punimeve ose braktisjen e tyre, si dhe masat që do të merren për të parandaluar pasojat.

Kufijtë e ndërprerjes së punës dhe të shtyerjes në kohë të punimeve do të përcaktohen nga palët në një procesverbal të ngjarjes.

Neni 22

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Koncesionit

Marrëveshja e koncesionit do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe pasi të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet dhe infrastukturën publike".

Neni 23

Klauzola të përgjithshme

Kjo Marrëveshje është hartuar në 8 (tetë) kopje origjinale, 4 (katër) prej të cilave do të merren nga Organi Shtetëror i Autorizuar dhe 2 (dy) kopje do të merren nga Koncesionari.

Neni 24
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Problemet ose mosmarrëveshjet ndërmjet palëve që kanë lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje koncesioni, nuk do të anulojnë detyrimet e palëve sipas kësaj Marrëveshjeje.

Palët janë të angazhuara të zgjidhin çdo mosmarrëveshje, duke u bazuar në vullnetin e mirë.

Në të kundërt, çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Marrëveshje koncesioni, do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

Neni 25
Seksionet

Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje penalizon palët sipas detyrimeve të marra prej tyre, me vendim të gjykatës së mësipërme.

Në rast vonesash në realizimin e projektit, të përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të nenit 11, kur kanë kaluar më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë vonesë, Koncesionari detyrohet të paguajë OSHA-në për çdo vonesë penalitetin prej 0.01% të vlerës së investimit të parealizuar.

Neni 26
Bashkëpunimi ndërmjet OSHA dhe Koncesionarit

Organi Shtetëror i Autorizuar dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.

Përveç rasteve kur bien dakord me shkrim për ndonjë formë tjetër, korrespondenca do të dërgohet me letër me postë, telegram ose fax, në adresën e mëposhtme:

ORGANI SHTETËROR I AUTORIZUAR	KONCESIONARI
Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës	"Wonder" Sh.a.,
Sheshi Skënderbej, nr.2, Tiranë	Rruga "Ismail Qemali"
Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit	Qendra e Biznesit, kati i III-të
Sheshi Skënderbej, nr.2, Tiranë	Pallati përballë INIMA-s

ANEKSI NR.1
Hidrocentrali Sasaj Sarandë

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
I.	**Kanali i derivacionit**				
1	Germim dheu	m^3	3,000	300	900 000
2	Mbushje shtrese zhavorri	"	1,300	1,350	1,755,000
3	Beton M 150	"	500	13,500	6,750,000
4	Beton M 200	"	50	14,900	745,000
5	Hekur betoni	ton	5	76,000	380,000
II.	**Baseni me presion**				
1	Gërmime	m^3	22,000	300	6,600,000
2	Mbushje me dhe	"	1,500	180	270,000
3	Beton M. 150	"	3,000	13,500	40,500,000
4	Hekur betoni	ton	15	76,000	1,140,000
5	Mbushje me zhavorr shtesë	m^3	1,200	1,350	1,620,000
6	Konstruksione metalike	ton	5	135,000	675,000

7	Shtresë rruge e asfaltuar	m^2	800	2,550	2,040,000
III.	**Shkarkuesi anësor**				
1	Gërmim dheu	m^3	2,500	300	750,000
2	Shtresë zhavorri	“	50	1,350	675,000
3	Beton M.150	“	400	13,500	5,400,00
4	Hekur betoni	ton	2	76,000	152,000
IV.	**Dhoma e droselit**				
1	Beton M.150	m^3	50	13,500	675,000
2	Mur tulle	“	40	9,500	380,000
3	Mbulesë	m^2	35	2,500	87,000
V.	**Tubacioni i turbinës**				
1	Gërmim dheu	m^3	25,000	300	7,500,000
2	Gërmim shkëmbi	“	2,000	9,500	19,000,000
3	Beton M.150	“	1,800	13,500	24,300,000
4	Beton M 200	“	200	14,900	2,980,000
5	Hekur betoni	ton	10	76,000	760,000
6	Konstruksione metalike	“	20	135,000	2,700,000
7	Tubacion metalik 1100 mm	“	290	140,000	40,600,000
VI.	**Ndërtesa e centralit e n/st**				
1	Gërmim	m^3	9,100	300	2,820,000
2	Beton M 200	“	1,850	14,900	27,565,000
3	Vëllime ndërtese	“	4,800	8,500	40,800,000
VII.	**Kanali i largimit**				
1	Gërmime	m^3	600	300	180,000
2	Beton M.150	“	350	13,500	4,725,000
3	Hekur betoni	ton	20	76,000	1,520,000
4	Mur me gobiona	m^3	800	3,400	2,720,000
	Shuma (I-VII)	**lekë**			249,664,000
VIII.	**Linja 35 KW**	“			98,000,000
	Shuma (I-VIII)	“			357,664,000
	Montime 10%	“			35,766,000
	Shuma	“			393,430,000
	Shpenzime plotësuese 11%	“			43,277,000
	Shuma	“			436,707,000
	Ngritje kantieri 2%	“			8,734,000
	Shuma	“			445,441,000
	E adhura neto 15%	“			66,816,000
	Shuma	“			512,258,000
	fondi rezervë 7%	“			35,858,000
	Shuma	“			548,116,000
	TVSH 20%	“			109,623,000
	Shuma	**lekë**			657,739,000
a.	**Shuma (konv.U.S.D.)**	$			4,700,000

b.	Pajisje teknologjike hidroelektromekanike	$	4,200,000
	Shuma (a+b)	$	8,900,000
	Projekti	$	150,000
	Shpronësimet	$	400,000
	Shuma totale	$	9,450,000